

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-39/13

Prishtinë,
18 Nëntor 2014

Në çështjen juridike të:

R. R.

Podujevë

Paraqitësi i ankesës

kundër.

M. L.

Novi Pazar
Sërbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi, Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/141/2012 lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08458 i datës 29 shkurt 2012, pas seancës gjyqësore kryesore të mbajtur me 18 Nëntor 2014 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e R. R. hedhen si e palejueshme për shkak se është paraqitur nga personi i paaautorizuar i deponuar kundër vendimit të KPCC /D/A /141/2012 lënda e regjistruara në AKP me numrin KPA 08458 i datës 29 shkurt 2012.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC /D/A /141/2012 lënda e regjistruara në AKP me numrin KPA 08458 i datës 29 shkurt 2012,

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 11 janar 2007, M.L. ,ka depozituar një kërkesë në AKP e regjistruar në AKP me nr. KPA08458 ,në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore pikërisht të babai i sajë i ndjerë D. R., duke pohuar se ai ishte pronar i pronave të kërkuara ku me ç ‘rast kërkon të drejtën e ri posedimit të ngastrës 94 në sipërfaqe prej 0.52.90 ha.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 23 maj 2002,nga organi kompetent.
 - Fletën poseduese i dt.24 shtator 2007,e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi ,me të cilën konstatohet se ngastra 94/1 në vendin e quajtur “Seishta -te shtëpia” zona kadastrale Peran,Komuna e Podujevës, është e regjistruar në emër të R.D.
 - Çertifikatë e vdekjes e lëshuar me 10 shtator 2008,nga organi kompetent në Nish, me të cilën konstatohet se D. R. ka vdekur me 28 janar 1987 në F .Peran, Komuna e Podujevës.
3. Ekipi i notifikimit sipas raportit të notifikimit dhe konfirmimit i AKP-së të datës 17 nëntor 2007 dhe 28 dhjetor 2010, ka konstatuar që sipas fletës poseduese të theksuar prona e kërkuar është regjistruar në emër R. D.
4. Sipas raportit të verifikimit i AKP-ës i dt.15 gusht 2008 të gjitha provat e propozuara nga paraqitësja e kërkesës janë verifikuar pozitivisht.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KPCC 141/2012 ,që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 08458 i datës 29 shkurt 2012, ka vendosur që paraqitësja e kërkesës ka dëshmuar se D.R. është pronar i pronës së kërkuar dhe se paraqitësja e kërkesës ka të drejtën e posedimit të asaj prone .Në arsyetimin e këtij vendimi theksohet se pala përgjegjëse paraqiti kundërshtim duke u bazuar në notifikimin e

pasaktë. Ndërkaq pas notifikimit të saktë ata nuk kanë tërhequr kundërshtimin edhe pse nuk kërkuan të drejtën ligjore për atë pronë.

Pretendimet ankimore:

6. M. L. vendimin e ka pranuar me 10 korrik 2012, ndërkaq përgjigje ankesë ka paraqitur më datë 26 mars 2014.
7. R.R. ankesë kundër vendimit ka paraqitur me 10 janar 2013, i cili nuk ka marr pjesë në procedurën notifikimit dhe publikimit të AKP-ës. Në pretendimin ankimor thekson se vendimi i komision është i gabuar. Ngastrën kadastrale e 94 e ka ble Sh.I. në vitin 1981 prej një serbi dhe se me rastin e bartje është gabuar kur është bartur vetëm 61 ari. Kjo ngastër është në sipërfaqe prej 01.14.00 ha.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesave:

8. Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vlerësimit të vendimit ankimor dhe ankesave të paraqitura sipas nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është hedhur si e palejueshme për shkak se është paraqitur nga personit i paautorizuar.
9. Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi ankesën (deklaratën) e ankuesit si të palejueshme për shkak se të njëjtën e ka paraqitur si person i paautorizuar, sipas nenit 186 par. 3 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase, R. R. jo vetëm që nuk ka marr pjesë në procedurën e notifikimit dhe publikimit lidhur me interesin ligjor për pronën që është objekt i kërkesës, duke paraqitur prova juridikisht të vlefshme por edhe në procedurën ankimore nuk ka paraqitur dëshmi për legjitimitetin aktiv ose pasiv që i referohet kësaj çështje juridike pronësore.
10. Për më tepër, ai duke kundërshtuar vendimin e KPCC në formë të deklarates nuk paraqet ndonjë autorizim juridikisht të vlefshëm për ta përfaqësuar palën ndërgjyqëse në këtë çështje juridike-pronësore.
11. Përpos kësaj, pala ankuese nuk mund të kërkon me ankesë më shumë prej asaj që ka kërkuar në procedurën në të cilën është marr vendimi ankimor, madje as edhe diçka tjetër. Kjo ngase sipas nenit 258 par 1 të LPK-ës është i ndaluar ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo shqyrtimit kryesor.

12. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 ,duke hedhur ankesën si të palejueshme ,është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-